



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3813/11 prot.

Tiranë, më 10.5.2019

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 314/11, datë 10.5.2019

**“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN E SJELLJES SË
NËPUNËSVE CIVILË GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Në zbatim të Kreut 2, nenit 5 dhe nenit 37 të Ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2013 “Për rregullat e etikës në administratën publike, Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore,

KONSTATOJ:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 540, datë 25.4.2019, “Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore”, ka orientuar njësitë përgjegjëse, me qëllim vijueshmërinë normale të punës, të pa ndikuar nga fushata zgjedhore, gjatë veprimtarisë së trupës së nëpunësve civilë.

Në këto rrethana, mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:
 1. Z. Shtjefën Zyla, Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Kryetar.
 2. Znj.Elsa Vorfi, Specialist, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit, Anëtar
 3. Përfaqësues i DAP, Anëtar.
2. Koordinatorin e Grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces, si dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, do të jetë znj.Elsa Vorfi, Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit.

3. Grupi i Monitorimit të hartojë Rregulloren e Brendshme të Veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregullime specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore.
4. Me Rregulloren e hartuar dhe me këtë Urdhër të njihen të gjithë nëpunësit civilë dhe të informohet Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil brenda datës 15.5.2019, duke vënë në dispozicion kopjen e praktikës.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Grupi i Punës dhe Zyra e Arkiv Protokollit.
6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Enea Hoti

